



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**KGJK. Nr. 221/2020**  
**Datë: 29 shtator 2020**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 105 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12, nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 67 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në mbledhjen e 239-të, të mbajtur me datë 29 shtator 2020, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Z. Sylë Lokaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Pejë, propozohet tek Presidenti i Republikës së Kosovës, për lirim nga detyra e gjyqtarit, për shkak të përfundimit të mandatit, me arritjen e moshës së pensionimit, me datë 01 tetor 2020.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Konform nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, gjyqtarit Sylë Lokaj, sipas fuqisë ligjore i përfundon mandati i gjyqtarit pasi që i njëjti me datë 01 tetor 2020, arrin moshën e pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

KGJK, bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës, Sh. T. Z. Hashim Thaçi, të liroj nga detyra gjyqtarin Sylë Lokaj.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Skender ÇOÇAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe
- Arkivit të KGJK-së.